



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:250652  
Datë: 29.03.2024  
Numri i dokumentit: 05525599

Ca.nr.3023/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli, kryetare e kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Hysni Bardheci, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses-propozueses së masës së sigurimit M.G. nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson J.O., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës-kundërshtarës së sigurimit Ndërmarrja Publike Komunale Trafiku Urban Sh.A me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson J.SH., udhëheqës i zyrës ligjore tek e paditura, duke vendosur sipas ankesës së paditëses/ propozueses së masës së sigurimit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.6878/2023 të datës 13.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pabazuar ankesa e paditëses - propozueses së masës së sigurimit M.G. nga Prishtina, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.6878/2023, i datës 13.02.2024, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin C.nr.6878/2023 të datës 13.02.2024, vendosi si në vijim: “Refuzohet propozimi i paditëses-propozueses së sigurimit M.G. nga Prishtina për caktimin e masës së sigurimit, me të cilën ka kërkuar që të: Urdhërohet e paditura-kundërshtari i sigurimit Ndërmarrja Publike Komunale Trafiku Urban sh.a që lidhur me konkursin .... të datës

14.09.2023 të shpallur nga Ndërmarrja Publike Komunale Trafiku Urban Sh.a për pozitën Udhëheqës i Burimeve Njerëzore që të pushoj të gjitha proceset deri në zgjidhjen e kësaj çështje juridike si dhe ti ndalohet Ndërmarrjes Publike Komunale Trafiku Urban Sh.a që të publikoj shpallje publike apo interne për plotësimin e pozitës udhëheqës i Burimeve Njerëzore si në Konkursin ..... të datës 14.09.2023 të shpallur nga Ndërmarrja Publike Komunale Trafiku Urban Sh.a deri në zgjidhjen e kësaj çështje juridike nga gjykata.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ankesë ka parashtruar paditësja – propozuesja e masës së sigurimit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që të aprovohet në tërësi ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktvendimi dhe të aprovohet kërkesa për caktimin e masës së sigurimit, ose aktvendimi të anulohet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa e paditëses-propozueses së masës së sigurimit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja-propozuesja e sigurimit, M.G. nga Prishtina, në gjykatën e shkallës së parë me datë 17.11.2023 ka ushtruar padi kundër të paditurës Ndërmarrja Publike Komunale Trafiku Urban Sh.a, me kërkesë për anulimin e vendimit dhe konkursit të shpallur nga e paditura për pozitën Udhëheqës i Burimeve Njerëzore. Duke e kontestuar ligjshmërinë e vendimit për anulim konkursi, me arsyetimin se i njëjti vendim është përfshirë me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale, paditësja ka pohuar se është bërë e besueshme e drejta e saj subjektive, përderisa i ka plotësuar të gjitha kriteret ligjore për t'u pranuar në-vendin e punës për të cilin ka aplikuar. Prandaj, deri në përfundimin e kontestit me vendim meritator dhe në mënyrë që paditëses - propozueses të masës së sigurimit, të mos i shkaktohet dëm i pariparueshëm, pasi paditësja-propozuesja do të humb të drejtën që të jetë udhëheqëse e Burimeve Njerëzore në kuadër të Ndërmarrjes Publike Trafiku Urban Sh.a, nga këto arsye gjykatës i ka propozuar që të caktoj masën e sigurimit - pezullimin e ekzekutimit të vendimit për rekrutimin dhe përzgjedhjen e udhëheqësit.

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit, i vlerësoi pretendimet e palëve ndërgjyqëse të dhëna në parashtresa dhe në seancat e dëgjimit, si dhe vlerësoi provat materiale të deponuara në shkresat e lëndës dhe konstatoi se propozuesja e sigurimit deri në këtë fazë të procedurës nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive, si dhe ekzistimin e rrezikut se me mos caktimin e masës do të vështirësohet dukshëm, apo do t'i pamundësohet realizimi i kërkesës. Këtë vlerësim e mbështeti me referim në dispozitat e nenit 297.1 pikës a) dhe b) të LPK-së, ku parashihet se masa e sigurimit mund të caktohet a) *në qoftë se propozuesi i sigurimit e bën të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, si dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurës së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me*

*ndonjë mënyrë tjetre me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave ose në ndonjë mënyrë do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.*

Nga arsyet e parashtruara dhe me referim në dispozitën ligjore nga neni 297.1 pika a) dhe b) e LPK-së, vendosi që propozimin për masën e sigurimit, ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata e Apelit e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë si të ligjshëm dhe të drejtë për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së dhe as në shkeljet tjera të pretenduara në ankesën e paditëses – propozueses së masës së sigurimit.

Gjykata e shkallës së dytë si të pambështetura i vlerëson pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi dispozitivi i aktvendimit është i qartë, i ekzaminueshëm dhe në harmoni të plotë me pjesën e arsyetimit, ku gjykata ka treguar faktet dhe rrethanat që kanë qenë me ndikim për refuzimin e propozimit, në atë mënyrë që aktvendimi i atakuar i përmbush kërkesat ligjore nga neni 160 par 3 dhe 4 të LPK-së. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar një procedurë të rregullt për shqyrtimin e propozimit, ashtu që palëve ndërgjyqëse iu është mundësuar parashtrimi i pretendimeve të ndërsjella, propozimi i provave në të cilat i mbështesin faktet e pohuara, - e të cilat janë vlerësuar me kujdes, ashtu që në raport me faktet e rastit, me vendosjen si në dispozitivin e aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore nga neni 297.1, pika a) dhe b) e LPK-së, duke e refuzuar si të pabazuar propozimin, pasi ka gjetur se në rastin konkret nuk plotësohen kumulativisht kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë, ashtu të parapara si në dispozitën e nenit 297.1 të LPK.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që gjykata e shkallës së parë në vendosjen sipas propozimit për masën e sigurimit, i ka marrë në vlerësim të gjitha faktet e pohuara nga ndërgjyqësit dhe provat e bashkëngjitura për vërtetimin e tyre, e të cilat prova kanë qenë të rëndësishme për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës, gjersa gjykata e shkallës së parë në këtë fazë të procedurës, nuk ka aprovuar propozimin për marrjen e provës të propozuar nga paditësja e që i referohet testit me shkrim të paditëses dhe kundërkandidates tjetër, pasi edhe sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, shtjellimi i provave të tilla në këtë fazë qartazi do të ndikonte në paragjykimin përkatësisht zgjidhjen e çështjes kryesore në mënyrë përfundimtare, përderisa propozimi për masën e sigurimit duhet të trajtohet në një mënyrë të tillë që të shmangë çdo lloj perceptimi, sipas të cilit gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel, apo nuk është e paanshme në gjykim.

Po ashtu, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk është bërë e besueshme as ekzistimi i rrezikut që pa caktimin e masës për sigurimin e kërkesëpadisë, propozueses do t'i pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës, për faktin se e paditura – kudërshtarja e sigurimit, është ndërmarrje publike me karakter të përhershëm të veprimtarisë, prandaj edhe nuk ekziston asnjë rrezik për tjetërsim, fshehje apo ngarkim të pasurisë, rrethana që merren në shqyrtim sipas nenit 297.1 pikës b) të LPK-së, për të vlerësuar plotësimin kumulativ të kushteve për sigurim të kërkesëpadisë, krahas besueshmërisë për ekzistimin e të drejtës subjektive apo të kërkesës.

Nga arsyet e parashtruara, Gjykata e Apelit pa u lëshuar në vlerësime të mëtejme, thekson se aktvendimi për refuzimin e propozimit për masë të sigurimit, nuk duhet kuptuar si prejudikim i çështjes kryesore sipas padisë konkrete, pasi gjykata e shkallës së parë mbi bazën e gjendjes faktike e cila do të vërtetohet pas zhvillimit të procedurës sipas padisë, përfundimisht do të mund të vlerësoj dhe të vendos për themelësinë e kërkesëpadisë.

Nga të lartcekurat e në pajtim me dispozitat nga neni 208 dhe 209 par.1 pika b) të LPK, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ca.nr.3023/2024, me datë 28.03.2024.

Kryetare e kolegjit

Hunaida Pasuli